



**Republika e Kosovës
Komuna Malishevë**



Në bazë të Ligjit Nr. 06/L – 114 për zyrtarët publikë, Neni 34 (2 dhe 3) dhe Rregullores (QRK) NR. 16/2020 për pranimin dhe karrierën në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, Nenet: 7 dhe 9, Komuna Malishevë shpall:

Konkurs

Pranim

Aplikimi është i hapur për të gjithë kandidatët e interesuar.

Emri i grupit	Specialistë të Përgjithshëm të Tatim- Taksave apo mbledhjes të të ardhurave
Institucioni	Komuna Malishevë
Nr. i Referencës	RN00009158
Kodi	RPC0002902
Data e njoftimit	02.06.2022
Afati për aplikim	23.06.2022 - 30.06.2022



1. Përshkrimi i përgjithshëm i punës

- Identifikon pronat që do të tatohen dhe pronat që do të lirohen;
- Identifikon tatimpaguesit sipas Ligjit dhe kryen hetime administrative për këtë qëllim , nëse është e nevojshme;
- Klasifikon pronat e paluajtshme;
- Inspekton pronat e paluajtshme;
- Konstaton shkeljet e dispozitave ligjore dhe propozon vendosjen e gjobave Përkatëse;
- Mbledhë, organizon dhe kryen verifikimin paraprak të informacionit të tregut që mund të përdorët për vlerësimin e pronave;
- Dërgon/ dorëzon njoftimet, faturat e tatimit në pronë , qertifikatat e vlerës së vlerësuar dhe aktet tjera zyrtare;
- Bashkëpunon dhe mbështetë zyrtarët e tjerë të Sektorit të tatimit në pronë;
- Bashkëpunon dhe shkëmben informacion me Agjencinë Kosovare për Krahësim dhe verifikim të pronës, Gjykatat apo çdo autoritet tjetër publik, kompetent për të shqyrtuar rastët e uzurpimeve të paligjshme në Kosovë;
- Përbushë çdo përgjegjësi/detyrë tjetër të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi apo të përcaktuar nga Shefi i Sektorit të Tatimit në Pronë.

2. Kërkesat e përgjithshme për praninë

- Të jetë shtetas i Republikës së Kosovës;
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- Të zotërojë njërën nga gjuhët zyrtare, në pajtim me Ligjin për Gjuhët;
- Të jetë i aftë në pikëpamje shëndetësore për të kryer detyrën përkatëse;
- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një veprë penale me dashje;
- Të mos ketë në fuqi një masë disiplinore për largim nga një pozitë e zyrtarit publik, të pushuar sipas këtij ligji.

3. Kërkesat e përgjithshme formale

- Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to.
- Fakulteti Juridik, Ekonomik;
- Kualifikime të posaçme formale:
- Përvoja e punës e kërkuar: Nuk kërkohet.



4. Kërkesat (Njohuri, Aftësi dhe Cilësi) e përgjithshme të nevojshme

- Njohuri profesionale specifike në fushën përkatëse të punës, të fituar përmes arsimimit dhe trajnimeve bazike;
- Aftësi për të kuptuar dhe zbatuar praktikat operative për të përmirësuar efikasitetin;
- Njohuri lidhur me procedurat standarde administrative/teknike në një fushë të caktuar;
- Aftësi për të punuar me vet-iniciativë në kuadër të planeve dhe procedurave të përcaktuara;
- Shkathtësi të mira të komunikimit, përfshirë aftësinë për të dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point).

5. Pozitat aktualisht të lira

Kodi	Nr. i Referencës	Titulli i pozitës	Klasa e pozitës	Koeficienti	Institucioni	Organizata / Vendi i punës
RPC0002724	RN00008970	Zyrtar për Tatimin në Pronë	Profesional 3	6	Komuna Malishevë	Drejtoria për Ek.Financa dhe Buxhet / Zyrtar për Tatimin në Pronë

6. Mënyra e aplikimit

Përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

7. Dokumentacioni që duhet paraqitur për aplikim

- Kopjet e diplomave të dhëna nga institucionet arsimore
- Kopjet e dëshmisë së punësimit
- Kopjet e dëshmisë së trajnimeve

8. Mënyra e vlerësimit të kandidatëve/aplikantëve

- Testimi me shkrim
- Vlerësimi i biografisë
- Intervistë

9. Fusha e njohurive, cilësive dhe aftësive që do të vlerësohen

- Njohuri nga fusha e tatimit në pronë;
- Shkathtësi për të organizuar punën e vet dhe për të koordinuar punën me eprorin dhe stafin;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese të informacionit;
- Aftësi për përmbushje të detyrave dhe punëve nën presion;
- Komunikimi, vendimmarrja dhe bashkëpunimi.



10. Mënyra e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët

- Përmes email dhe portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>)

11. Shpallja e rezultateve përfundimtare

- Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, fituesi do të shpallet përmes portalit për rekrutim elektronik (<https://konkursi.rks-gov.net>). Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike.

Të dhëna shtesë:

Komunitetet joshumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në shërbimin civil të Kosovës, siç specifikohet në Ligj.
Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre, gjinia më pak e përfaqësuar dhe personat me aftësi të kufizuara inkurajohet të aplikojë për pozitat e shpallura.
Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen